

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 e shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

për angazhimin me kontratë për punë dhe detyra specifike sikur në vijim:

Titulli i pozitës:	DIZAJNER ME PËRVOJË
Orët e punës:	Jo më shumë se 120 ditë në vit (kryesisht punë në distancë)
Numri i referencës:	KON132024
Kohëzgjatja e emërimit:	Kontratë për punë dhe detyra specifike
Adresa:	Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë e producentit:

- Të ideojë dhe përgatisë dizajne për plotësimin, përmirësimin dhe avancimin e uebfaqes së FKPK-së.
- Të ideojë dhe përgatisë materiale të përshtatshme për publikim në rrjetet sociale.
- Të realizojë dizajne për materiale të tjera informuese dhe vetëdijësuese për nevoja të FKPK-së: fletushka, broshura, pasqyra dhe pano (të dimensioneve dhe përdorimeve të ndryshme).
- Të ndihmojë FKPK-në kur nevojitet printimi i materialeve në sasi dhe cilësi të lartë.
- Të jetë i përpiktë dhe i gatshëm për t'i vizualizuar qartësisht idetë dhe kërkesat e FKPK-së.
- Të kryejë detyra të tjera, nëse kërkohet, në fushën e dizajnit dhe faqosjes së materialeve/raporteve të ndryshme.

Kriteret e konkursit:

- | | |
|------------------|--|
| Arsimimi: | <ul style="list-style-type: none">Diplomë të studimeve të larta (e dëshirueshme).Certifikime profesionale (është përparësi). |
| Përvoja: | <ul style="list-style-type: none">Së paku tri vjet përvojë të dëshmuar në fushën e dizajnit.Njohuri të avancuara në përdorimin e pakos së Adobe (sidomos në: InDesign, Illustrator, Photoshop).Njohuri për përdorim të CorelDRAW (është përparësi). |

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur **prej 26 nëntorit 2024 e deri më 10 dhjetor 2024 në ora 23:59 (CET)**.
- Aplikimi bëhet vetëm përmes email-it në adresën: **recruitment@trusti.org**, me referencë: **"Dizajner me përvojë"**.
- Email-it duhet t'i bashkëlidhen edhe dokumentet në vijim (të gjitha në formatin pdf):
1) Biografia (CV); 2) Letërmotivimi dhe 3) Diploma e certifikime (nëse ka).

Vërejtje:

- Aplikacionet pa dokumentet e lartcekura të bashkangjitura, ose që nuk janë në formatin e kërkuar, NUK do të shqyrtohen.
- Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet do të kontaktohen.

FKPK-ja është punëdhënëse që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!